




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 15.03.2022

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 234, të datës 15.03.2022, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, bazuar në nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (GZ Nr.28/2008), nenin 43, të Statutit të Komunës, Nr.98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi me Nr. 234 të datës 15.03.2022 për caktimin e shumave financiare për subvencionim në fushën e arsimit për kategoritë përfituese, si në vijim:
 - 1.1. Për studentët në studime bachelor – 400€;
 - 1.2. Për studentët në studime master – 500€;
 - 1.3. Për studentët për studime të doktoratës – 600€;
 - 1.4. Për studentë me studime jashtë vendit – 600€;
 - 1.5. Për nxënësit me nevoja të veçanta -500€;
 - 1.6. Për nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente 400€ ;
 - 1.7. Për vizita studimore jashtë vendit të studentëve -500€;
 - 1.8. Për mësimdhënësit me projekte për ngritjen e cilësisë -400€;
 - 1.9. Për bartjen (transportin e nxënësve) për fushat e arsimit obligativ të cilat nuk ofrohen në komunën tonë – 400€;
 - 1.10. Për studentet me studime bachelor që kanë qenë të angazhuar në mësimdhënie (zëvendësime) me dëshmi nga shkolla – 400€;
 - 1.11. Për studentet me studime master që kanë qenë të angazhuar në mësimdhënie (zëvendësime) me dëshmi nga shkolla – 500€;
1. Çdo propozim nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit për ndryshimin e shumave financiare për subvencionim në fushën e arsimit për kategoritë përfituese sipas këtij Vendimi do të shqyrtohet dhe miratohet nga Kryetari i Komunës.
2. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit, nga Kryetari i Komunës.

Akti i dorëzohet:

- 1x Kryetarit të Komunës
- 1x Drejtorisë së Arsimit
- 1x Arkivit

